



---

**Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare**

---

**Këshillim mbi „Profesioni administrator falimentimi - aspektet normative dhe praktika gjyqësore“.**

Në këshillimin e pestë kushtuar praktikës gjyqësore, të mbajtur më 06 prill 2017, u diskutua mbi „Profesionin e administratorit të falimentimit – aspektet normative dhe praktika gjyqësore“.

Në këshillimin e mbajtur në kuadër të projektit „ Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,„ morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, gjykatës të falimentimit dhe gjykatës që merren me lëndë që daling nga procedura e falimentimit, administratorë të falimentimit, juristë, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara.



Janë analizuar autorizimet dhe detyrat e administratorit të falimentimit, aspektet normative të licencimit të administratorëve të falimentimit, si dhe praktika gjyqësore gjatë emërimit, respektivisht zgjedhjes që bëhet sipas metodës së përzgjedhjes elektornike nga lista e administratorëve të falimentimit. Përzgjedhja e administratorit të falimentimit bëhet sipas metodës së përzgjedhjes elektronike dhe kur bëhet fjalë për riorganizim sipas planit të hartuar paraprakisht, ku gjykata duhet të ketë të dhëna mbi njohuritë speciale të administratorit të falimentimit.

Sistemi për kontroll mbi punën e administratorit të falimentimit përfshin gjykatësin e falimentimit, organet e kreditorëve, Odën e administratorëve të falimentimit dhe Ministrin e Ekonomisë. Përgjegjësia disiplinore, e cila ka për qëllim mbrojtjen e interesave të komunitetit profesional si dhe mbrojtjen e interesave të të gjithë pjesëmarrësve tjerë në procedurën e falimentimit, është vendosur në odë përmes organeve disiplinore, të përzgjedhur nga ana e Kuvendit të Odës. Ato janë: propozues për fillimin e procedurës disiplinore dhe këshilli disiplinor. Në vend të kësaj procedure njëshkallëshe, modeli sllloven i funksionimit të organeve disiplinore nënkupton procedurë dyshkallëshe, me komisione disiplinore treanëtarëshe, të përbërë nga anëtarë të më shumë institucioneve kompetente.

Projekti realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.

Shkup, 06.04. 2017